



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, me 23 shtator 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**nga mbledhja e Komisionit për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Fatmire Berisha,
Besa Gaxherri, Radmilla Vujoviç dhe Ismet Beqiri.

Munguan: Xhezair Murati, Suzan Novoberdaliu, Ramadan Gashi.
Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:
Ahmet Isufi, Kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 23.09.2008**
- 3. Shqyrtimi i Rregullores së re të Punës së Kuvendit**
- 4. Rekomandim lidhur me kërkesën për zëvendesimin e deputetit Sabit Rrahmani**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.09.2008

Procesverbali nga mbledhja e datës 23.09.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Rregullores së re të punës së Kuvndit

Në lidhje me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes tha, meqenëse sot nuk janë prezent të gjithë anëtarët e komisionit atëherë miratimin përfundimtar do ta lejmë për mbledhjen e radhës në mënyrë që kur të procedohet në seancë komisioni ta ketë një qëndrim të përbashkët, prandaj sot do ti diskutojmë vetëm nëse dikush ka vërejtje në këtë draft.

Besa Gaxheri parashtroj disa vërejtje. Te **rregulla 26**, që ka të bëjë me kodin e mirësjelljes së deputetëve, tha se kjo rregull s'duhet të jetë në rregullore pasi që është përfshirë edhe në shtojcë, **rregulla 28**, ku përdoret shkelja e rënd e Kushtetutës, mendoj se duhet të thuhet vetëm shkelje të Kushtetutës sepse nuk ka shkelje të rënd e të lehtë po ka vetëm shkelje të Kushtetutës, **rregulla 42**, te fjalia çështjet urgjente mund të ngritën me marrëveshje të Kryetarit të Parlamentit, mendoj se duhet të jetë vetëm me njoftim sepse marrëveshja edhe mund të mos arrihet dhe çështjet urgjente nuk mund të presin, te **rregulla 58**, mendoj se duhet të futet edhe një pikë që ministri dhe zëvendësministri nuk mund të jenë anëtar të komisioneve parlamentare.

Ajo gjithashtu tha se duhet të rregullohet edhe çështja e pagesave të nën komisioneve, poashtu theksoi se qëndron prapa asaj, se te komisioni për buxhet së paku nënkryetari i këtij komisioni duhet të jetë nga opozita.

Hydajet Hyseni, propozoi që në rregullore të ceket edhe një dispozitë që shprehjet në rregullore të Kuvndit të jenë në harmoni me shprehjet parlamentare të botuara më heret nga OSBE-ja.

4. Rekomandim lidhur me kërkesën për zëvendësimin e deputetit Sabit Rrahmani

Kryesuesi tha se, sipas rregullores së Kuvndit në fuqi deputeti Sabit Rrahmani, i ka plotësuar të gjitha kriteret për heqjen e imunitetit, poashtu edhe në bazë të kërkesës së parashtruar nga gjykata, të përgatitet rekomandimi për heqjen e imunitetit të cilën në mbledhjen e radhës do ta miratojmë dhe ta procedojmë për seancë.

Hydajet Hyseni tha, edhe pse ne të gjithë jemi të njohur me rastin e deputetit në fjalë, unë këtu desha ta theksoi vetëm një çështje, se marrja e imunitetit nuk donë me thënë se i

merret edhe mandati, sepse janë disa kritere që duhet të plotësohen për të cilat mund ti merret mandati.

Kryesuesi tha se për deputetin në fjalë ekzistojnë të gjitha arsyet për të cilat mund ti merret mandati.

Ismet Beqiri tha, unë propozoi që ne ta kryejmë pjesën e heqjes së imunitetit dhe pastaj ai rekomandim, hap debat për pjesën e marrjes së mandatit, Kuvendi pastaj do ti analizoj arsyet se pse duhet ti merret mandati dhe do të nxjerr një vendim.

5. Të ndryshme

Në lidhje me këtë pikë, **znj.Besa Gaxherri** tha, unë edhe pse ndoshta nuk jam mirë e njoftuar, kisha deshtë ta ngriti çështjen e pasaportave zyrtarë për deputet, sepse kamë digju se disa ministra, deputet e zyrtar të tjerë janë pajisur me pasaportë zyrtarë, prandaj kisha deshtë ta di se kush duhet ta inicioj këtë çështje, sepse mendoj se kjo duhet të shkoj në formë zyrtare e jo të aplikojmë ne deputetët veç e veç.

Ismet Beqiri tha, kjo çështje rregullohet nëpërmes shefave të grupit parlamentar, pra mu për aplikim, më është kërkuar vetëm një kopje e letërnjoftimit, çështje kjo që është rregulluar nga shërbimi i deputetëve.

Kryesuesi tha se ne duhet të interesohemi për këtë çështje, e drejt do të ishte që Kryesia e Kuvendit të lëshoj një vendim që deputetët të njoftohen zyrtarisht në lidhje me pajisjen e tyre me pasaporta zyrtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 12.40

Ahmet Isufi
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit